



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1653/6prot

Datë 14.10.2021

V E N D I M
K.P.P. 767/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.10.2021 shqyrtoi ankesat me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-02528-08-10-2021, me objekt “Blerje materiale pastrimi dhe detergjent”, me fond limit 3 305 234 (tre milion e treqind e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.08.2021, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF
Tiranë, Dajt Linzë, Rruga Muhamet Veliu, Pallati ILIAD, shkalla 1, kati 1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Shkodër
Rruga Kolë Heqimi 11, Shkodër

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.08.2021, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-02528-08-10-2021, me objekt “Blerje materiale pastrimi dhe detergjent”, me fond limit 3 305 234 (tre milion e treqind e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.08.2021, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Shkodër.

II.2. Në datën 23.08.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE),rezulton se autoriteti kontraktor në datë 26.08.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ANBIM” ShPK	1.720.000 lekë	skualifikuar
2. “EURO MEGA 2010” ShPK	2.700.300 lekë	skualifikuar
3. “Malvina Visoka” Pf	2.896.000 lekë	skualifikuar
4. “ATLANTIK 3” ShPK	3.188.500 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 26.08.2021 operatori ekonomik “Malvina Visoka” Pf është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

Personi (personat) që veprojnë si anëtarë të organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP nuk janë të deklaruar në formularin përmbledhës të e vetdeklarimit

Dëshmia për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate me vërtetim të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara janë me pak se 20% e fondit limit.

Flete-Analiza për rezultatet e testimeve zyrtare për të vërtetuar pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, që duhet të paraqesin, nuk janë të lëshuara nga Institucione të autorizuar, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike (Detergjente + Solucion pastrimi) .

II.5. Në datën 27.08.2021, është publikuar njoftimi i anulimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe në datë 30.08.2021 është publikuar njoftimi i anulimit në Buletinin Nr.130 datë 30.08.2021.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 03.09.2021 operatori ekonomik ankimes “Malvina Visoka” Pf, ka paraqitur ankesë njëkohësisht, si pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar kualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me pretendimet si më poshtë vijon:

[...]Që operatori ekonomik “Malvina Visoka” Pf nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit neni 76/1 (jo vetëm që kemi plotësuar këtë kriter, por kemi bashkëngjitur dhe vërtetim të Gjykatës së Tiranës të nenit 76/1.

Dëshmia për shërbime të mëparshme të ngjashme janë më pak se 20% (ose ka dorëzuar dëshmi të ngjashme që përfaqësohen me fondin limit të AK).

Fletë Analizë për detergjentët nuk janë të lëshuara nga institucione të autorizuar (OE “Malvina Visoka” Pf ka dorëzuar analiza nga laboratorë të akredituar ndërkombëtarë të cilët janë të kualifikuar për analiza detergjent të ndryshëm, pasi i vetmi laborator i autorizuar në Shqipëri ISHTI nuk është i akredituar për analiza të këtyre produkteve gjë që vërtetohet në përgjigjen zyrtare me DT26.06.2021 me nr. Prot 3876 ku shprehet qartë, se laboratori ynë është një laborator i paakredituar për këto produkte, ekzistojnë 2 laboratorë të akredituar në Itali njëri prej të cilëve është ARCHIMEDE në adresë Viale della Repubblica 71/D 70125 Bari Italy tel +390805566124, email www.archimeddecology.it, të cilët AK lehtësisht mund të bënte kërkime ose dërgonte email në lidhje me analizat e kryera në laboratorin e tyre pasi çdo fletëanalizë ka raport-test të produktit me nr. Të veçantë për çdo produkt (bashkëngjitur po ju dorëzojmë fletë-analizë nga produktet tona.[...]

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1653/2 prot., datë 03.09.2021 lidhur me pretendimet mbi arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Me shkresën nr. 2020/2 prot., datën 10.09.2021, protokolluar me tonën me nr. 1653/3 prot., datë 13.09.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Malvina Visoka” Pf në të cilën konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.9. Me shkresën nr. 1653/4 prot., datën 07.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” Pf dokumentacion në cilësinë e provës për të vërtetuar marrjen dijani mbi njoftimin e anulimit nga ana e autoritetit Kontraktor.

II.10. Me shkresën protokolluar me tonën nr. 1653/5prot., datë 11.10.2021 operatori ekonomik ankimues “Malvina Visoka” Pf ka informuar, se ka marrë dijani në lidhje me njoftimin e anulimit të procedurës objekt-shqyrtimi në datën 27.08.2021 ora: 13:35. (bashkëlidhur print screen e sistemit elektronik të prokurimeve).

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Në datën 11.08.2021, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-02528-08-10-2021, me objekt “Blerje materiale pastrimi dhe detergjent”, me fond limit 3 305 234 (tre milion e treqind e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.08.2021, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Shkodër.

III.1.1. Në datën 23.08.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE),rezulton se autoriteti kontraktor në datë 26.08.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“ANBIM” ShPK	1.720.000 lekë	skualifikuar
“EURO MEGA 2010” ShPK	2.700.300 lekë	skualifikuar
“Malvina Visoka” Pf	2.896.000 lekë	skualifikuar

III.1.3. Në datën 26.08.2021 operatori ekonomik “Malvina Visoka” Pf është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentat si më poshtë vijon:

Personi (personat) që veprojnë si anëtarë të organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP nuk janë të deklaruar në formularin përmbledhës të e vetdeklarimit

Dëshmia për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate me vërtetim të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara janë me pak se 20% e fondit limit.

Flete-Analiza për rezultatet e testimeve zyrtare për të vërtetuar pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, që duhet të paraqesin, nuk janë të lëshuara nga Institucione të autorizuar, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike (Detergjente + Solucion pastrimi).

III.1.4. Në datën 27.08.2021, është publikuar njoftimi i anulimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe në datë 30.08.2021 është publikuar njoftimi i anulimit në Buletinin Nr.130 datë 30.08.2021.

III.1.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 03.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Malvina Visoka” Pf ka paraqitur ankesë njëkohësisht si pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar kualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me pretendimet si më poshtë vijon:

[...]Që operatori ekonomik “Malvina Visoka” Pfnuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit neni 76/1 (jo vetëm që kemi plotësuar këtë kriter por kemi bashkëngjitur dhe vërtetim të Gjykatës së Tiranës të nenit 76/1.Dëshmia për shërbime të mëparshme të ngjashme janë më pak se 20% (oe ka dorëzuar dëshmi të ngjashme që përfaqësohen me fondin limit të AK). Fletë Analizë për detergjentët nuk janë të lëshuara nga institucione të autorizuar (OE “Malvina Visoka” Pf ka dorëzuar analiza nga laboratorë të akredituar ndërkombëtarë të cilët janë të kualifikuar për analiza detergjent të ndryshëm pasi i vetmi laborator i autorizuar në Shqipëri ISHTI nuk është i akredituar për analiza të këtyre produkteve gjë që vërtetohet në përgjigjen zyrtare me DT26.06.2021 me nr. Prot 3876 ku shprehet qartë se laboratorin ynë është një laborator i paakredituar për këto produkte, ekzistojnë 2 laboratorë të akredituar në Itali njëri prej të cilëve është ARCHIMEDE në adresë Viale della Repubblica 71/D 70125 Bari Italy tel +390805566124, email www.archimeddecology.it, të cilët AK lehtësisht mund të bënte kërkime ose dërgonte email në lidhje me analiza e kryera në laboratorin e tyre pasi çdo fletëanalizë ka

raport test të produktit me nr. Të veçantë për çdo produkt (bashkëngjitur po ju dorëzojmë fletë analizë nga produktet tona.[...]

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1653/2 prot., datë 03.09.2021 lidhur me pretendimet mbi arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

III.1.7. Me shkresën nr. 2020/2 prot., datën 10.09.2021, protokolluar me tonën me nr. 1653/3 prot., datë 13.09.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Malvina Visoka” Pf në të cilën konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III.1.8. Me shkresën nr. 1653/4 prot., datën 07.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” Pf dokumentacion në cilësinë e provës për të vërtetuar marrjen dijeni mbi njoftimin e anulimit nga ana e autoritetit Kontraktor.

III.1.9. Me shkresën protokolluar me tonën nr. 1653/5prot., datë 11.10.2021 operatori ekonomik ankimues “Malvina Visoka” Pf ka informuar, se ka marrë dijeni në lidhje me njoftimin e anulimit të procedurës objekt shqyrtimi në datën 27.08.2021 ora: 13:35. (bashkëlidhur print screen e sistemit elektronik të prokurimeve).

III.1.10. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.11. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.12. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.13. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

- a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;
- b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;
- c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;
- ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;
- d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.1.14. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, **është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.** Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor me shkresën nr. 2020/2 Prot., datë 10.09.2021 protokolluar me tonën me nr. 1653/3 Prot., datë 13.09.2021, informacionit të operatorit ekonomik ankimues me shkresën nr. 1653/5prot., datë 11.10.2021 rezulton, se në datën 27.08.2021 nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. KPP vëren se operatori ekonomik ankimues “Malvina Visoka” Pf, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik më datë 03.09.2021, ku kërkon kualifikimin e tij, ndërkohë nga verifikimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike aktin e “njoftim-anulimi”, më datën 27.08.2021 moment procedural nga i cili fillon afati i ankimimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në tejkallim të afatit 7 ditor konkretisht afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga **publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.**”, pasi nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike njoftimi i anulimit në datën 27.08.2021 për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka filluar në datën 27.08.2021, datë në të cilën është publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon se ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e

Prokurimit Publik në datë 03.09.2021, konsiderohet e paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Malvina Visoka” Pf për procedurën e prokurimit Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-02528-08-10-2021, me objekt “Blerje materiale pastrimi dhe detergjent”, me fond limit 3 305 234 (tre milion e treqind e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.08.2021, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” Pf.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri